

1 E enjte, 20 korrik 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuari paraqiten përmes videolidhjes]

4 --- Seanca fillon në orën 9.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e  
6 Gjykatës, ju lutem paraqisni çështjen.

7 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Kjo është  
8 çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim  
9 Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
11 dhe mirëmëngjesi të gjithëve.

12 Sot do të mbarojmë me dëshminë e dëshmitarit 04586. Vërej  
13 për procesverbalin që z. Thaçi, z. Veseli, z. Krasniqi dhe z.  
14 Selimi po na ndjekin përmes videolidhjes. Kanë hequr dorë nga  
15 e drejta e tyre për të qenë të pranishëm fizikisht, dhe kanë  
16 dhënë pëlqimin me shkrim për këtë gjë në zbatim me rregullën  
17 96(2).

18 Para se të sjell dëshmitarin, ka një aspekt i cili duhet  
19 trajtuar. Është një urdhër me gojë sa i takoj shtyrjes së  
20 afatit për t'u përgjigjur kërkesës së dytë të Prokurorisë në  
21 bazë të rregullës 155.

22 Dje, Mbrojtja e Krasniqit kërkoi shtyrje të afatit për  
23 t'u përgjigjur mocionit të dytë të Prokurorisë sipas rregullës  
24 155.

25 Ka ndonjë gjë nga Prokuroria në lidhje me këtë?

1 Z. BRADFIELD: [Përkthim] Jo.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws, keni  
3 diçka për të thënë?

4 Z. LAWS: [Përkthim] Asgjë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtja e  
6 Thaçit?

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Jo, e mbështesim.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë gjë  
9 nga Mbrojtja e Veselit?

10 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Jo.

11 Z. TULLY: [Përkthim] E mbështesim dhe ne kërkesën.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis ka  
13 ndonjë gjë për të shtuar?

14 Z. ELLIS: [Përkthim] Në qoftë se keni nevojë për më shumë  
15 hollësi, unë mund t'ju jap këto hollësi.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, është e  
17 plotë kërkesa.

18 Prandaj, Trupi Gjygues vendos të shtyjë afatet për  
19 përgjigje lidhur me mocionin e dytë të Prokurorisë sipas  
20 rregullës 155, dhe ky afat tashmë është 20 ditë nga  
21 shpërndarja e mocionit.

22 Me kaq mbyll urdhrin me gojë.

23 Përpara se të vijë dëshmitari, ka ndonjë gjë për të  
24 thënë?

25 Z. KEHOE: [Përkthim] Sa i takon kundërpyetjeve të këtij

1 dëshmitari, ne u konsultuam me njëri-tjetrin dhe bashkë me  
2 kolegët, dhe bashkërisht në këtë pikë asnjë nga ekipet e  
3 mbrojtjes nuk do t'i bëjë pyetje këtij dëshmitari.

4 Dhe më duhet t'ju them që ky vendim u mor si rezultat i  
5 situatës së djeshme pasi pamë dëshmitarin. Ne në qoftë se  
6 është nevoja mund t'i bëjë kundërpvetjet, por ama diskutuam me  
7 njëri-tjetrin. Bashkërisht morëm vendim që askush nuk do t'i  
8 bëjë pyetje këtij dëshmitari.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptojmë  
10 këtë gjë, s'kam asgjë për të thënë në lidhje me këtë.

11 Do t'i kërkojmë dëshmitarit të vijë. Ne kemi pak pyetje  
12 për të, meqë e kemi këtu. Që ta kuptojë që jemi të interesuar  
13 në këtë aspekt. Kështu do veprojmë për momentin.

14 Ka gjë tjetër?

15 Sekretare, silleni dëshmitarin.

16 [Dëshmitar vijon dëshminë përmes videolidhjes]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes  
18 dëshmitar, a më dëgjon?

19 DËSHMITARI: [përmes videolidhjes] Po, ju dëgjoj.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sot do  
21 vazhdojmë me dëshminë tuaj. Dua t'ju kujtoj se keni ende  
22 detyrimin të thoni të vërtetën siç dhe e lexuat ju vetë në  
23 deklaratën solemne dje.

24 Mos harroni të flisni afër mikrofonit dhe prisni pesë  
25 sekonda para se të përgjigjeni, dhe flisni ngadalë.

1 Në qoftë se keni nevojë për një pushim, na thoni dhe ne  
2 do t'ju plotësojmë këtë kërkesë.

3 Avokatët na thanë se nuk kanë pyetje për ty sot, sepse  
4 kanë lexuar deklaratat tuaja. Por disa nga gjykatësit kanë  
5 pyetje. Kështu që këtë do të bëjmë për momentin.

6 Në fillim Gjykatësi Mettraux.

7 SEKRETARJA E SEANCËS: [përmes videolidhjes] Më lejoni për  
8 procesverbal të konfirmoj se në vendndodhjen bashkë ku jemi me  
9 dëshmitarin është një pjesëtar i ZMMD-së dhe unë Sekretarja e  
10 Gjykatës.

11 DËSHMITARI: W04586 [Vijon]

12 [Dëshmitari paraqitet përmes videolidhjes]

13 Pyetje nga Trupi Gjykses:

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirëmëngjes, Dëshmitar. I  
15 lexova deklaratat e tua dhe kam një pyetje të thjeshtë. Pasi  
16 ndodhën këto ngjarjet që keni përshkruar kur ju morën vëllaun,  
17 edhe çdo gjë tjetër gjatë asaj periudhe, ti a u përpoqe t'i  
18 tregoje ndokujt apo të raportoje ndokund këtë që i ndodhi të  
19 afërmit tuaj?

20 PË. Po.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të na tregosh kujt  
22 ia kallëzove këtë ngjarje, kujt ia raportove këtë ngjarje?

23 PË. [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më fal, se mbase s'e bëra  
4 të qartë shumë pyetjen. Më shumë e kisha fjalën, a ia  
5 raportove ndonjë organi, jo për kushërinjtë, jo familjarët,  
6 por ndonjë organi, ndonjë policie, a ndonjë Prokurorie  
7 asokohe, ndonjë organi të zbatimit të ligjit, ndonjë  
8 autoriteti?

9 PË. Po tash kam harru unë, që 23 vjet kur i kam tregue, i kam  
10 harru. Dhe s'jam mirë prej diabetit. Kam harru që 23 vjet.  
11 Vetëm me vllavin ça kam bisedu.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptojmë që është e  
13 vështirë, nuk po këmbëngul, po thjesht po t'u kujtua me sa  
14 mban mend ti. A ka pasur atëherë ndonjë institucion ku mund të  
15 shkoje? Në qoftë se të kujtohet, në qoftë se s'të kujtohet,  
16 s'ka problem. Për ta kallëzuar këtë gjë.

17 PË. Po, atëherë UNMIK-ut i kam tregu unë, që pse unë kur kam  
18 dalë për Shqipëri, kanë pyetë mue. Prej të gjitha gjanave m'i  
19 kanë pyetë, sa a ka ndodhur ndonjë send? I thashë, "Po,  
20 vllavin ma kanë marrë individët". "Kush janë ata individët?"  
21 Thashë, që "[REDAKTUAR]. Ata  
22 dy individa të tjerë nuk i njofi."

23 Edhe ka vazhdu masanej, vazhdimin vëllaut, kam me çu, ata  
24 më kanë kërku me shku me e marrë. Unë s'kam guxu me shku me e  
25 marrë. I kam thanë, "[REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04586 (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 6

1 [REDAKTUAR]" Kurse tha, ti patjetër duhet me ardhë me e marrë. Edhe  
2 unë ia bana rrajsh, "Hajt, pra se vij e marr". Se i raportirën  
3 kallashët. "Hajt", thashë, "se vij e marr".

4 Dhe kam shku në shtëpi, i kam tregu vllavit të madh, kemi  
5 bisedue. Aty çka me bo tash na? S'kishëm çka të bojmë, e çova  
6 një -- si thatë ju mos me tregu për kushërinjtë, por unë  
7 s'kisha kënd me çu. Janë [REDAKTUAR] dhe  
8 kushërinin. Masandej ata kanë shkue, a kanë shku deri në vend  
9 aty, a më kanë rrejtë mue, nuk e di. Por s'i kanë pranue me i  
10 lanë [E pakuptueshme]. E s'kisha çka me bo. Katër herë kanë  
11 shku, katër herë kanë thanë "Le të vjen [REDAKTUAR]. Vllavi vetë le  
12 ta merr." Kurse vllavi jem, kish çu fjalë mbas një individi,  
13 si ka qenë --

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit,  
15 faleminderit. Iu përgjigjët pyetjes, faleminderit shumë.  
16 Faleminderit për kohën tuaj.  
17 PË. Me nder qofshi.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatës  
19 Gaynor, ka një pyetje.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në një nga deklaratat ke  
21 thënë se kishte më shumë frikë nga UÇK-ja se nga serbët. Se  
22 nga serbët e dije çfarë të prisje, por UÇK-ja nuk ishte armiku  
23 yt.

24 A mund të na tregosh një çikë më shumë, çfarë ke dashë të  
25 thuash kur ke thënë më shumë kishte frikë nga UÇK-ja? Çfarë ke

1 dashë të thuash me këtë fjali?

2 PË. Po, qe po ju tregoj. Nga UÇK-ja kam pasë frikë se më  
3 mbysin mu. Kurse më kanë kërku për q'atë arsye. Tash unë i kam  
4 thanë, kam me u mbrojtë, ama me u mbrojtë prej UÇK-së, a me u  
5 mbrojtë prej serbit. Unë s'kam ditë nga me ia mbajtë. Kam  
6 ndejtë nëpër male me familje. Kam ndejtë nëpër male, as kam  
7 ndejtë në shtëpi.

8 Se me i kallëzu këto fjalë, shumë gjatë shkon. Sa më kanë  
9 hy edhe mbrenda mu, për me na vra. Në ora 2.00 të natës. Është  
10 kanë ftohtë, ka pasë mjegull. Rrymë s'ka pasë. I kanë thanë  
11 vllavit se ata s'e kanë njoftë shtëpinë teme ku jam, i kanë hy  
12 vllavit. I kanë thanë vllavit, po [E pakuptueshme], i kanë  
13 ndigju një vajzë e vllavit, i ka ndigju kur e kanë kërcy  
14 murin. Vllavi e ka kapë kallashin, u mbështet në derë të  
15 dhomës mbrenda. Edhe ai ka gjujtë, qe ai individ, ka gjujtë  
16 fill e në shtëpi aty mbrenda. Edhe vllavi menjëherë një  
17 raportir kallash edhe e gjun, ia run dorën, ia run. Edhe e  
18 plagos dora i kputë dy gishta. Edhe kur ia ka këputë dy gishta  
19 i ka thanë shqip, "Oh, më myte bre".

20 Atëherë, ne s'kemi ditë gja, se unë jam kanë tu rujtë  
21 nëpër oborr, çdo qoshe të shtëpisë e kam rujtë. Edhe ka thanë,  
22 "më myte bre", por ai nuk është kanë vetëm. Ai është kanë me  
23 shumicë individë. Përjashta ata janë kanë krejt individët, por  
24 ata e kanë bo budallë. Se ai i panjofun, ai individ, e kanë  
25 shti me kërcy murin. E ai ka hy mbrenda, e vllau atë e ka

1 plagu, ia ka këputë dy gishtat.

2 E kur jemi qu ne -- qutë jemi kanë, se ne dojshim me dalë  
3 edhe prej shtëpisë. Mirëpo, kur dulëm prej shtëpisë në  
4 mëngjes, gishtat jashtë ishin tu lujt, gishtat e këputun në  
5 oborr. Por ai ka ikë, por ne kemi ndjekë gjakun e atij, nga i  
6 ka ra udhës gjaku. Dhe erdhi në krye të katundit. Në krye të  
7 katundit e kemi ndjekë gjakun. Kur jemi shku në krye të  
8 katundit, jemi tutë me shku ma tutje. Se ata kanë ndejtë me  
9 një fshat, Randobravë, UÇK-ja. Kanë ndejtë, e jemi kthy prapë  
10 ne. Prej krye të katundit --

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit, faleminderit.  
12 Faleminderit për shpjegimin. I kemi dhe me shkrim të gjitha  
13 këto. I kemi lexuar me shumë kujdes. Nuk kam më pyetje.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë  
15 pyetje nga palët?

16 Z. BRADFIELD: [Përkthim] Jo.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

18 Z. KEHOE: [Përkthim] Jo.

19 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Jo.

20 Z. TULLY: [Përkthim] Jo.

21 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Jo.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,  
23 mbaruam me dëshminë tuaj. Me kaq e mbaruam dëshminë tuaj për  
24 sot. Je i lirë të largohesh e të kthehesh në shtëpi.  
25 Faleminderit shumë që erdhët.



1 DËSHMITARI: [përmes videolidhjes] Prej jush faleminderit  
2 [E padëgjueshme].

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit  
4 për deklaratat që ta kuptojmë çfarë ka ndodhur. Faleminderit  
5 për këto që thatë edhe sot, që ta kuptojmë më mirë çfarë i ka  
6 ndodhur motrës edhe vëllait, të gjitha këto i kemi marrë  
7 shënim. Je i lirë, edhe një herë faleminderit që erdhët.

8 DËSHMITARI: [përmes videolidhjes] Faleminderit edhe prej  
9 jush.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare,  
11 mund ta shoqëroni dëshmitarin jashtë ambientit ku ndodheni.

12 [Dëshmitari përfundon dëshminë përmes  
13 videolidhjes]

14 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës  
15 këshillohen]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
17 Videolidhja u ndërpre me dëshmitarin.

18 Faleminderit të gjithëve. Ka qenë një periudhë  
19 interesante dhe kemi goxha më shumë përpara. Faleminderit për  
20 prezantimet, faleminderit për bashkëpunimin, faleminderit të  
21 gjithëve në sallën e gjyqit. Kaq kisha unë për momentin.

22 A ka ndonjëri ndonjë parashtrim për të bërë? Atëherë, jo  
23 me sa duket. Ju falënderoj.

24 Do të rifillojmë pas pushimit të Gjykatës me pesë  
25 dëshmitarët e radhës.

1 Seanca mbyllet.

2 --- Seanca mbyllet në orën 09.18

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25